

Në bazë të nenit 43, paragrafi 1. Ligji mbi Qeverinë („Fletorja zyrtare RS”, nr 55/05,71/05-përmirësim, 101/07 dhe 65/08) dhe me vendimin e Qeverisë 05 numër: 06-351/2001-2 nga 8 shkurti i vitit 2001 si dhe me vendimin e Qeverisë 05 nr: 30-7203/2003 nga 6 nëntori 2003.

Qeveria bjenë këtë

VENDIM
MBI RREGULLIMIN E TRUPIT KOORDINUES TË QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË SERBISË PËR KOMUNAT E PRESHEVËS, BUJANOCIT DHE
MEDVEGJËS

1. Përbërjen e Trupit Koordinues. Trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës (në tekstin vijues: Trupi Koordinues) ka përbërjen e ngushtë dhe të gjërë.

2. Përbërja e ngushtë e Trupit Koordinues. Në përbërjen e ngushtë të Trupit Koordinues për komuat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë do të marrin pjesë: kryetari i Trupit Koordinues, zëvendëskryetari i Trupit Koordinues, gjashtë nënkryetarët e Trupit Koordinues, drejtori i Shërbimit të Trupit Koordinues, kryetarët e Kuvendeve Komunale të komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës si dhe deputetët popullorë në Kuvendin Popullorë të Serbisë nga komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës.

Funksionin e zëvendëskryetarit të Trupit Koordinues do ta ushtrojnë kryetarët e komunave të Preshevës dhe Bujanocit.

Kryetarët e komunave të Bujanocit dhe Preshevës do të zëvendësohen qdo vit në detyrën e zëvendëskryetarit të Trupit Koordinues.

Tre nënkryetarët e Trupit Koordinues zgjedh Qeveria me propozimin i kryetarit të Trupit Koordinues.

Kryetarët e komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës njëherit janë edhe nënkryetarët të Trupit Koordinues.

Kryetarët e Kuvendeve të komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës janë pjesëtarë në përbërjen e ngushtë të Trupit Koordinues.

3. Përbërja e gjërë e Trupit Koordinues. Përbërjen e gjërë të Trupit Koordinues, përpos anëtarëve të përbërjes së ngushtë e përbëjnë edhe anëtarët në pozitë.

Anëtarët e përbërjes së gjërë sipas pozitës janë zëvendëskryetarët e komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, zëvendëskryetarët e kuvendeve komunale të komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, udhëheqësit e grupeve punuese të Trupit Koordinues dhe udhëheqësit e grupeve punuese nga radhët e vetëqeverisjes lokale.

Anëtarë i përbërjes së gjërë sipas pozitës do të jetë përfaqësuesi i pakicës Rome i cili emërohet nga Këshilli Nacional i pakicës Rome.

4. Grupet punuese të Trupit Koordinues. Trupi Koordinues përbëhet edhe nga grupet punuese të cilat më parë meditojnë dhe japin propozime operacionale si dhe pyetje të cilat janë të lidhura me detyrën e Trupit Koordinues. Grupet punuese edukohen për: zhvillimin ekonomik dhe infrastrukturor, integritet politik dhe shoqëror, sigurim dhe drejtësi, përforsimin e kapaciteteve

të qeverisjes lokale dhe aftësimi i saj, për edukim, kulturë, informim, sport dhe rini si dhe shëndetësi dhe politikë sociale.

Anëtarët e grupeve punuese i emëron kryetari i Trupit Koordinues të propozuymë parë nga organet kompetente.

Qdo grup punues do t'i ketë 12 anëtarë.

Grupi punues përbëhet prej tre anëtarëve nga radhët e ministrisë, prej tre anëtarëve nga radhët e pushtetit lokal të komunave të preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës të cilët emërohen nga kryetari i Trupit Koordinues, në propozimin e Kuvendeve të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës të cilët më parë propozohen nga grupet e deputetëve ashtuqë do t'i përshtaten përbërjes etnike të komunave.

Punën e qdo grupi punues do ta udhëheqë anëtari i Trupit koordinues nga resoret e ministrive të cilin e emëron kryetari i Trupit Koordinues.

Qdo grup punues do ta ketë edhe zëvendësin e saj nga radhët e vetëqeverisjes lokale të cilin e emëron kryetari i Trupit Koordinues.

Mënyra e punës së grupeve punuese bëhet në bazë të Rregullores së Trupit Koordinues.

5. Kompetencat e Trupit Koordinues. Kryetari i Trupit koordinues përfaqëson Trupin Koordinues, udhëheqë punën e tijë, punon në koordinimin e tijë në përgjegjësitë e organeve të pushtetit lokal të cilat janë paraparë me vendimet e Qeverisë në realizimin e detyrave të cilat janë si rrjedhim i Programit dhe vendimit të Trupit Koordinues të aprovuar nga Qeveria.

Kryetari i Trupit Koordinues emërohet nga Qeveria.

Për punën e tijë dhe për punën e Trupit Koordinues, Kryetari i Trupit Koordinues jep logarinë Qeverisë.

Kryetari i Trupit Koordinues raporton Qeverinë rreth punës së Trupit Koordinues.

Zëvendëskryetari i Trupit koordinues, ndihmon dhe zëvendëson kryetarin e Trupit Koordinues (në rast të mungesës së tijë) në koordinimin e punës së pushteteve lokale si dhe në marrjen e vendimeve për realizimin e Programit të Trupit Koordinues.

Përbërja e ngushtë e Trupit Koordinues përpilon plane, programe operative, vendime dhe Rregulloren e punës së Trupit Koordinues.

Përbërja e gjërë e Trupit Koordinues përpilon strategjinë e punës së Trupit Koordinues dhe përcjell strategjinë e realizimit.

Grupet punuese përgatisin propozim vendimet, planet dhe programet operative të Trupit koordinues.

Drejtori i Shërbimit të Trupit Koordinues udhëheq punën e tijë në bazë të ligjit mbi zyrtarët e pushtetit lokal.

6. Funksionimi i Trupit Koordinues. Trupi Koordinues nuk mundë të ndikojë në ngushtimin e të drejtave dhe kompetencave të organeve të qeverisjes lokale të cilat janë të garantuara me ligj.

Funksionimi i Trupit Koordinues duhet të jetë në funksion të realizimit të synimeve të vëra në vitin 2001 nga Programi i Qeverisë Federative dhe Qeverisë Republikane për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, si dhe arrëveshjes mbi principet primare për zgjedhjet e parakohshme në Serbinë Jugore, të nënshkruar më 18 mars 2002 në Beograd si dhe dokumentet tjera strategjike dhe planet aksionale.

Duke u nisur nga parimet se shoqëria demokratike dhe pluraliste duhet të plotësoj kushte dhe t'u mundësojë të gjitha bashkësive lirinë e shprehjes si dhe të ruajnë dhe kultivojnë identitetin e tyre, Trupi Koordinues do të punojë në krijimin e shoqërisë multietnike dhe

multifunkionale të krijuar në principet demokratike duke i respektuar të drejtat individuale dhe kolektive sipas standardeve më të larta.

Trupi Koordinues do të angazhohet në formimin e qeverisjes multietnike në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë si dhe kyqjen e Shqipëtarëve në institucionet shtetërore në marrjen e vendimeve.

7. Rregullorja. Trupi Koordinues ka rregulloren e tijë.

Rregulloren e Trupit Koordinues e përpilojnë së bashku anëtarët e ngushtë të përbërjes së Trupit Koordinues.

Vendimet në përbërjen e ngushtë dhe të gjërë të Trupit Koordinues bien me konsensus.

8. Dispozita përfundimtare. Ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndërpritet të vazhdojë vendimi mbi rregullimin e Trupit Koordinues të Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë („Fletorja zyrtare e RS”, nr 78/07)

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në „fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë”.

05 nr: 02-1903/2009-02
Në Beograd, 9.prill, 2009.

QEVERIA

**NËNKRYETARI I PARË I QEVERISË
ZËVENDËSI I KRYETARIT TË QEVERISË**

Ivica Daqiq